



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.41/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Kymete Kicaj - kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Gordana Laban Zuvic, anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me seli në Prishtinë dhe ankesën e parashtruar nga Subjekti Politik Lista Serbe me seli në Mitrovicën e Veriut, paraqitur kundër vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Vendimi Nr. Nr. 01/85-2025, datës 14.01.2025, për Miratimin e Përbërjes së Ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) dhe Vendimi 01/84-2025, datë 14.01.2025, për Miratimin e Përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve në Vendvotimet e Rregullta dhe me Kusht, të datës 14.01.2025, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 18.01.2025, mori këtë:

#### V E N D I M

REFUZOHEN të pabazuara ankesat: Anr.41/2025 e datës 16.01.2025, e parashtruar nga Gordana Laban Zuvic, anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me seli në Prishtinë, dhe Anr.42/2025 e datës 16.01.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Lista Serbe me seli në Mitrovicën e Veriut, paraqitur kundër vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Vendimi Nr. 01/85-2025, datës 14.01.2025, për Miratimin e Përbërjes së Ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) dhe Vendimi 01/84-2025, datë 14.01.2025, për Miratimin e Përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve në Vendvotimet e Rregullta dhe me Kusht, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025.

#### A r s y e t i m

PZAP më datë 16.01.2025, ka pranuar ankesat: Anr.41/2025 parashtruar nga Gordana Laban Zuvic, anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me seli në Prishtinë dhe Anr.42/2025 e parashtruar nga Lista Serbe me seli në Mitrovicën e Veriut, në të cilat theksohet se më 10 janar 2025, Subjekti Politik Lista Serbe dhe Gordana Laban Zuvic, anëtare e Komisionit Qendror të

Zgjedhjeve, në pajtim me nenin 77, paragrafi 5 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikë Kosovë, kanë paraqitur ankesa në Panelin Zgjedhorë për Ankesa dhe Parashtrësia kundër vendimit të KQZ-së, nr. 01/30-2025, datë 08. Janar 2025, Për miratimin e përbërjes së Ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) dhe Vendimin e KQZ-së Nr. 01/31-2025, datë 08.01.2025 Për miratimin e përbërjes së Këshillave të Votimit në vendvotimet e Rregullta dhe me Kusht.

Mëtutjue në ankesa theksohet se më 13 janar 2025, PZAP-i ka marrë VENDIM A.nr. 19/2025, duke vendosur si në vijim që:

*“Pranohen ankesat e bazuara Anr.19/2025 nga 10.01.2025. të vitit 2025, të dorëzuar nga subjekti jopolitik Lista Serbe me seli në Mitrovicën e Veriut, dhe Anr 22/ 2025, të dorëzuar nga Gordana Laban Zhuviq, anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me seli në Prishtinë, ANULOHEN Vendimi nr. 01/30-2025 nga 01.08.2025. për miratimin e përbërjes së ekipeve të numërimit në qendrat komunale të numërimit (QKN) dhe vendimin nr. 01/-2025, nga data 08.01.2025” miratimin e përbërjes së këshillave të votimit në vendvotimet e rregullta dhe vendvotimet e votimeve me kusht, të Komisionit Qendrorë Zgjedhorë dhe lënda i kthehet KQZ-së në rivendosje.*

Në vazhdim të ankesave thuhet se në procedurë të përsëritur dhe duke vepruar sipas vendimeve të formës së prerë (res judicata) të PZAP-it, A.nr, 17 /25, A.nr.18/25, A.nr. 20/25, A.br 19/25 të datës 11.01.2025 dhe A.nr.26/25 të datës 13.01.2025, KQZ-ja miratoi Vendimin Nr. 01/85-2025 të KQZ-së, datë 14 janar 2025 për miratimin e përbërjes së Ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) dhe VENDIMIN Nr. 01/84-2025 të KQZ-së, datë 14 janar 2025, për miratimi i përbërjes së Këshillave Zgjedhor në Vendvotimet e Rregullta dhe ato me Kusht.

Parashtruesit e ankesave theksojnë se Vendimi Nr. 01/84-2025 i datës 14 janar 2025, për miratimin e përbërjes së Këshillave të Votimit në Vendvotimet e Rregullta dhe ato me Kusht, është në kundërshtim me dispozitat e nenit 77, paragrafi 3 i ligjit nr. 08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme, përcaktohet se: *“Kryetarët e këshillave të vendvotimeve zgjidhen në mënyrë të barabartë nga katër (4) subjekte politike të certifikuara që kanë fituar numrin më të madh të votave për Kuvendin e Kosovës në zgjedhjet e fundit në atë komunë”*. Ndërsa paragrafi 4 i të njëjtit nen përcakton se: *“Pavarësisht nga qëndrimi paraprak i këtij neni, në rast nevojë, KQZ-ja ka autoritetin të emërojë anëtarë të KVV që nuk plotësojnë kërkesat e këtij neni”*.

Më tej në ankesë thuhet se Vendimi nr. 01/85-2025 i datës 14 janar 2025, për miratimin e përbërjes së Ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me dispozitat e nenit 20 të Rregullores së Zgjedhjeve 16/2024.

Parashtruesit theksojnë se në rivendosje, KQZ-ja është dashur që në bazë të rregullave dhe kritereve të përcaktuara, duke respektuar parimin e barazisë dhe përfaqësimit për të gjithë që marrin pjesë në garën zgjedhore, të shqyrtojë çështjen e përcaktimit të përbërjes së këshillave zgjedhore, në qendrat e votimit të rregullta dhe me kusht, si dhe përbërjen e ekipeve të numërimit në qendrat komunale për numërim

Me marrjen e vendimeve të kontestuara, sipas parashtrësve të ankesave KQZ-ja, bëri vetëm ndryshime kozmetike që nuk janë ligjore dhe nuk zbatoi nenin 77 paragrafi 3. Ligji nr. 08/L-

228, për Zgjedhjet e Përgjithshme, as nuk ka zbatuar nenin 20 të Rregullores së Zgjedhjeve 16/2024, si dhe nenin 3 të Rregullës Zgjedhore për Këshillat Zgjedhore.

KQZ-ja, duke mos respektuar rekomandimet e PZAP-it, të nxjerra në disa aktgjykime, mori vendime në të cilat nuk ndryshoi absolutisht asgjë në lidhje me këshillat e votimit në qendrat e votimit me kusht, bukvalisht nuk ndryshoi asnjë shkronjë apo numër, por ri-miratoi tabelën e njëjtë identike e cila ishte e njëjtë me Vendimin e mëparshëm të kontestuar nr. 01/31-2025 e datës 08.01.2025 Për miratimin e përbërjes së Këshillave të Votimit në vendvotimet e rregullta dhe me kusht.

Këto pretendime sipas ankuesve mund të vërtetohen lehtësisht duke krahasuar thjesht tabelat nga Vendimi i anuluar Nr. 01/31-2025 i datës 08.01.2025,5 për miratimin e përbërjes së Këshillave Zgjedhore në vendvotimet e rregullta dhe me kusht dhe vendimin e ri miratuar Nr. 01/84-2025, datë 14.01.2025 për miratimin e përbërjes së Këshillave Zgjedhore në vendvotimet e rregullta dhe me kusht vendimet që janë krejtësisht të njëjta.

Ndërsa në KQZ-ja, duke mos respektuar rekomandimet e PZAP-it, ka marrë vendime në të cilat ka bërë vetëm një korrigjim të vendimit të anuluar Nr. 01/30-2025, i datës 8 janar 2025, për miratimin e Përbërjes së Ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), kështu që në Komunën e Kamenicës, subjektit politik LDK i zvogëloi një anëtar dhe këtë anëtar ia shtoi subjektit politik Listës Serbe. Tutje, KQZ-ja bëri korrigjime të vogla në lidhje me numrin shumë të vogël të Këshillave Zgjedhore, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 77 të ligjit nr. 08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në disa komuna ( të specifikuar në ankesat e palëve ankuese).

Parashtuesit e ankesave pretendojnë se Vendimi Nr. 01/84-2025 i datës 14 janar 2025 për miratimin e Përbërjes së Këshillave të Votimit në Vendvotime të Rregullta dhe me Kusht dhe Vendimi nr. 01/85-2025 i datës 14 janar 2025, për miratimin e përbërjes së Ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) është plotësisht në kundërshtim me ligjin dhe në kundërshtim me Kushtetutën.

Përmes përgjigjes në ankesë KQZ-ja ka deklaruar si më poshtë:

Në vendimet e plotfuqishme të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa (PZAP) për A.nr 17/25, A.nr 18/25, A.nr 20/25, A.nr 19/25 të datës 11.01.2025 dhe A.nr 26/25 e datës 13.01.2025 e ka kthyer në rivendosje vendimet e KQZ-së: Vendimi Nr.01/30-2025, i datës 08.01.2025 për Miratimin e Përbërjes së Ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) dhe Vendimi Nr.01/31-2025, i datës 08.01.2025 i Komisionit Qendror i Zgjedhjeve për Miratimin e Përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve në Vendvotimet e Rregullta dhe me Kusht. Duke pasur parasysh se vendimet e PZAP-së, janë të detyrueshme për tu zbatuar, KQZ sipas nenit 77 paragrafi 5 i ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës në mbledhjen qarkulluese të mbajtur me datën 14.01.2025 ka miratuar përbërjen e Ekipeve të numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09 shkurt 2025, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 64 dhe nenin 101 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 20 paragrafi 1 dhe 4 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024

Qendrat Komunale të Numërimit, si dhe neni 3 parafi 1,2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.2 dhe të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024 Këshillat e Vendvotimeve.

Gjatë vendimmarrjes së përbërjes e Ekipeve të Numërimit në QKN-së, KQZ ka marr për bazë nenin 20 paragrafi 1 dhe 4 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 Qendrat Komunale të Numërimit, si dhe neni 3 parafi 1,2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.2 dhe të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024 Këshillat e Vendvotimeve si dhe si dhe gjatë vendimmarrjes për përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht ka marr për bazë nenin 64 paragrafi 2.10, nenin 75,76 dhe 77 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 2 paragrafi 2, 3 dhe 4, neni 3 paragrafi 1, paragrafi 2, nën paragrafi 2.1. dhe 2.2, paragrafi 1,2,3 dhe 4 dhe neni 3 parafi 1,2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.2 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024 Këshillat e Vendvotimeve.

Pretendimet e palës ankuese se vendimi i KQZ-së nr.01/85-2025 të datës 14.01.2025, për Përbërjen e Ekipeve të Numërimit në QKN-së dhe vendimi i KQZ-së, nr.01/84-2025 të datës 14.01.2025, për Përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht janë në Kundërshtim me nenin 24 dhe 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 77 të ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e përgjithshme të Republikës së Kosovës dhe nenin 20 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 Qendrat Komunale të Numërimit, dhe duke kërkuar nga KQZ të nxjerrë vendim për miratimin e përbërjes së KVV-ve në vendvotimet e rregullta dhe me kusht dhe ti ndaj subjektit politik Lista Serbe- 38 kryesues shtesë dhe 122 anëtar të KVV-ve për Vendvotimet e rregullta dhe Qendrat Komunale të Numërimit.

KQZ gjatë rishqyrtimit të vendimit për Përbërjen e KVV-ve në Vendvotimet e rregullta dhe me kusht si dhe emërimin e ekipeve të numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit, subjektit politik Srpska Lista i ka dhënë 3 anëtar në Vendvotimet e rregullat si dhe 1 rezerve në komunën e Istogut, 7 anëtar në Komunën e Fushë Kosovës si dhe 1 rezerve, 1 anëtar rezerve në komunën e Lipjanit, 1 anëtar në komunën e Prizrenit dhe 2 anëtar të KVV-ve në vendvotimet e rregullta dhe 1 anëtar rezervë në komunën e Zubin Potokut.

Subjekti politik ankues Srpska Lista sipas vendimit nr.01/84-2025 të datës 14.01.2025, për Përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09 shkurt 2025 ka pjesëmarrje në komuna:

Në vendvotimet e Rregullta: Gjilan, Istog, Klinë, Fushë Kosovë, Kamenicë, Laposaviq, Lipjan , Novobërdë, Obiliq, Rahovec, Pejë, Prishtinë, Prizren, Skenderaj, Shtërpçë, Viti, Vushtrri, Zubin Potok, Zveçan, Graçanicë, Ranilluk, Partesh, Kllokot, Mitrovica e veriut. Me gjithsej: 35 kryesues, 209 anëtar të KVV-ve dhe 31 rezerva.

Vendvotimet me kusht: Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan, Ranilluke, Partesh, Kllokot, Mitrovicë e Veriut. Me gjithsej: 4 kryesues dhe 3 anëtar të KVV-ve.

Subjekti politik ankues Srpska Lista sipas vendimit nr.01/85-2025 të datës 14.01.2025, për Përbërjen e Ekipeve të Numërimit në QKN-së për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09 shkurt 2025 ka pjesëmarrje në komuna: Gjilan, Laposaviq, Novobërdë, Shtërpçe, Zubin Potok, Zveçan, Graçanicë, Ranilluke, Partesh, Kllokot, dhe Mitrovicë e Veriut.

Andaj, pretendimet e palëve ankuese janë të pa bazuara për arsyeje se KQZ gjatë ndarjes së vendeve në Këshillat e Vendvotimeve është mbështetur në nenin 3 paragrafi 1 Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024, për Këshillat e Vendvotimeve.

Andaj, pretendimet e palëve ankuese mbi “zvogëlimin numrit e të KVV” nuk qëndrojnë për faktin se ndryshimet Ligjore dhe të akteve nënligjore tashme kanë përcaktuar qartë përbërjen dhe funksionet e secilit anëtar të KVV. Përqindja e votave të fituara qoftë në nivel qendror apo në nivel lokal, nuk është kriter i cili përcakton përbërjen e KVV në komunat përkatëse. I vetmi kriter ligjor që ka të bëjë është nenit 77 paragrafi 3 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili thotë se Kryesuesit e këshillave të vendvotimeve zgjidhen në mënyrë të barabartë në mesin e katër (4) subjekteve politike të certifikuara që kanë fituar numrin më të madh të votave për Kuvendin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë, ku edhe në këtë rast KQZ e ka anashkaluar këtë nen në disa raste, me qëllim të përfaqësimit sa më të madh të komuniteteve jo shumicë. Me gjithsej: 12 Kryesues, anëtar 49 si dhe 2 rezerva.

Nga statistikat që u ceken më lartë subjekti politik Srpska Lista edhe pse nuk i është nënshtruar pragut zgjedhor, por garon vetëm për vendet e garantuar sipas Kushtetutës neni 64, par. 2 nen paragrafi 1. Është përfaqësuar në 25 komuna me kryesues dhe anëtar të KVV-ve dhe ekipeve të numërimit në QKN.

KQZ-ja ka marrë për bazë edhe paragrafin 4 të nenit 77, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili i jep kompetencë KQZ-së që pavarësisht paragrafit paraprak të këtij neni, në rast se kërkohet, KQZ-ja ka kompetenca për të emëruar sipas zgjedhjes së saj anëtarët e KKV-ve të cilët nuk përmbushin kushtet sipas këtij neni.

Gjatë leximit të ankesës së subjektit ankues Srpska Lista mund të vërehet se ky subjekt politik ka qasje përjashtuese për subjektet tjera politike nga i njëjti komunitet duke kërkuar që të ketë me shumë përfaqësim se subjektet politike nga i njëjti komunitet. Për çka bie ndesh me kërkesën e këtij subjekti politik i cili ka kërkuar trajtim të barabartë me subjektet tjera për gjithë përfshirje dhe pjesëmarrje në zgjedhje.

Andaj, në bazë thënieve të lartcekura, konsiderojmë se ankesa e ankuesit, është e pa bazuar dhe si e tillë duhet të refuzohet.

Gjatë shqyrtimit të ankesës PZAP duhet të ketë parasysh se mos emërimi i KVV-ve brenda afateve të përcaktuara rrezikon procesin zgjedhor i cili tani është në fazën e fillimit të trajnimeve të KVV-ve.

Fillimisht paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr..05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar Ankesat A.nr.41/2025 i datës 16.01.2025 dhe A.nr.42/2025 i datës 16.01.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët A.nr.41/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesve.

Paneli, pas shqyrtimit të ankesave të parashtruara nga ankuesit, gjeti se:

- Ankesat janë të pa bazuara.

Pretendimet e palës ankuese se Vendimi Nr.01/85-2025, i datës 14.01.2025 për Miratimin e Përbërjes së Ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) dhe Vendimi Nr.01/84-2025, i datës 14.01.2025 i Komisionit Qendror i Zgjedhjeve për Miratimin e Përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve në Vendvotimet e Rregullta dhe me Kusht, se vendimet e kontestuara të KQZ-së janë në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli i vlerësoj si të pabazuara për faktin se me dispozita ligjore janë përcaktuar qartë përbërjet dhe funksionet e KVV, ku shprehimisht dispozita e nenit 77 par.3 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, parasheh se *“Kryesuesit e këshillave të vendvotimeve zgjidhen në mënyrë të barabartë në mesin e katër (4) subjekteve politike të certifikuara që kanë fituar numrin më të madh të votave për Kuvendin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë”*, ndërsa paragrafi 4 i këtij neni thekson se *“pavarësisht paragrafit paraprak të këtij neni, në rast se kërkohet, KQZ-ja, ka kompetenca për të emëruar sipas zgjedhjes së saj anëtarët e KVV-ve, të cilët nuk i përmbushin kushtet sipas këtij neni”*.

Palët ankuese pretendojnë se sipas vendimit nr.01/84-2025 të datës 14.01.2025, për Përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht dhe vendimit nr.01/85-2025 të datës 14.01.2025, për Përbërjen e Ekipeve të Numërimit në QKN, për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09 shkurt 2025, se KQZ-ja, bëri vetëm ndryshime kozmetike që nuk janë ligjore dhe nuk zbatoi nenin 77 paragrafi 3. Ligji nr. 08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme, as nuk ka zbatuar nenin 20 të Rregullores së Zgjedhjeve 16/2024, si dhe nenin 3 të Rregullës Zgjedhore për Këshillat Zgjedhore.

Pas verifikimit të provave të bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe përgjigjes së KQZ-së, paneli vërtetoi se subjekti politik, Lista Serbe sipas vendimit nr.01/84-2025 të datës 14.01.2025, për Përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09 shkurt 2025 ka pjesëmarrje në komuna: Në vendvotimet e Rregullta: Gjilan, Istog, Klinë, Fushë Kosovë, Kamenicë, Laposaviq, Lipjan, Novobërdë, Obiliq, Rahovec, Pejë, Prishtinë, Prizren, Skenderaj, Shtërpçë, Viti, Vushtrri, Zubin Potok, Zveçan, Graçanicë, Ranilluk, Partesh, Klllokot dhe Mitrovica e veriut, përfaqësohet me gjithsej: 35 kryesues, 209 anëtar të KVV-ve dhe 31 pozita rezerva. Ndërsa në Vendvotimet me kusht në komunat: Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan, Ranilluke, Partesh, Klllokot dhe Mitrovicë e Veriut, përfaqësohet me gjithsej: 4 kryesues dhe 3 anëtar të KVV-ve.

Paneli vlerësoi se pas rishqyrtimit të vendimit për përbërjen e KVV-ve, në Vendvotimet e rregullta dhe me kusht si dhe emërimin e ekipeve të numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit, subjektit politik Lista Serbe i ka dhënë 3 anëtar në Vendvotimet e rregullat si dhe 1 rezerve në komunën e Istogut, 7 anëtar në Komunën e Fushë Kosovës si dhe 1 rezerve, 1 anëtar rezerve në komunën e Lipjanit, 1 anëtar në komunën e Prizrenit dhe 2 anëtar të KVV-ve në vendvotimet e rregullta dhe 1 anëtar rezervë në komunën e Zubin Potokut, që do të thotë se pas

pranimin të vendimeve të PZAP-së, Anr.19/2025, të datës 13.01.2025 me të cilën çështje është kthyer në rivendosje në KQZ lidhur me vendimin me Nr. 01/30-2025 i datës 08.01.2025 dhe Nr.01/31-2025 i datës 08.01.2025, KQZ ka vepruar sipas rekomandimeve të PZAP-së, duke nxjerrë vendimin nr.01/84-2025 të datës 14.01.2025, për Përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht dhe vendimin nr.01/85-2025 të datës 14.01.2025, për Përbërjen e Ekipeve të Numërimit në QKN, me të cilët ka bërë plotësimin dhe ndryshimin në përfaqësimin e subjektit politik në fjalë konform rekomandimeve të PZAP-së.


Bazuar në të lartcekurat paneli vlerëson se KQZ ka bërë shpërndarjen e KVV-ve në vendvotimet e rregullta, me kusht dhe ekipet e numërimit në QKN në bazë të kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me ligj dhe aktet nënligjore ku ndarja është bërë duke trajtuar në mënyrë të barabartë për të gjitha subjektet politike në mënyrë që kjo përfshirje të reflektoj pjesëmarrjen e barabartë për të gjithë ata që marrin pjesë në procesin zgjedhor.

Përfundimisht paneli nga PZAP ka gjetur se KQZ-ja ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të barabartë për të gjitha subjektet politike, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, si për subjektet që kanë fituar numrin më të madh të votave në zgjedhjet e fundit, e po ashtu edhe për të gjitha subjektet tjera pjesëmarrëse dhe se mbi këtë arsye të njëjtave nuk iu është bërë ndonjë padrejtësi me vendimin nr.01/84-2025 të datës 14.01.2025, për Përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht dhe vendimin nr.01/85-2025 të datës 14.01.2025, për Përbërjen e Ekipeve të Numërimit në QKN, në këtë kontekst duhet pasur parasysh edhe dispozitën ligjore nën 77 par.4 të LZP-së e cila i jep të drejtë KQZ-së, për të emëruar anëtarë të KKV sipas zgjedhjes së saj, pa marrë parasysh numrin e votave të fituara në zgjedhjet e fundit.

Prandaj, nga arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 13 paragrafi 2 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2024, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, si dhe nenit 118 paragrafi 1 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke i refuzuar ankesat të pabazuara.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Anr.41/2025 më datën 18.01.2025

Kryesuese e Panelit  
Kymete Kica



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.